V E N D I M
Nr.25, datë 15.4.2002

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR SHQYRTIMIN E PROJEKTLIGJEVE TË PARAQITURA NË KUVEND PËR PROBLEMET E PRONAVE

Në mbështetje të neneve 22, 30 e 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Krijohet Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve"", i ndryshuar, projektligjit "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7699, datë 21.4.1993 "Për kompensimin në vlerë ose në troje të ish-pronarëve të tokave bujqësore, kullotave, livadheve, tokave pyjore dhe pyjeve"", i ndryshuar, propozuar nga Këshilli i Ministrave, si dhe të projekligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", propozuar nga një grup deputetësh.

II. Komisioni ka për qëllim dhe detyrë organizimin dhe koordinimin e punës për shqyrtimin e projektligjeve të përmendura në pikën I dhe paraqitjen e projektligjeve përfundimtare. Për realizimin e detyrës së tij, Komisioni bashkëpunon me specialistë të fushës, vendas dhe të huaj, si dhe me organizata të ndryshme të interesuara në këtë proces.

III. Komisioni përbëhet nga 15 anëtarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme parlamentare.

IV. Përbërja e Komisionit është si më poshtë:

Kryetar
Nënkryetar
Sekretar

Anëtarë:
1. Jemin GjanaPD
2. Zyhdi PepaPS
3. Spartak BrahoPS
4. Mustafa MuçiPS
5. Ylli BufiPS
6. Arben ImamiPAD
7. Vladimir MaloTë gjelbërit
8. Lekë ÇukajPSD
9. Saimir CurriPDr
10. Bamir TopiPD
11. Ejup TabakuPS
12. Maksim BegejaPR
13. Ethem FezollariPLL
14. Alfred ÇakoBK
15. Arjan Starova LD

V. Ky Komision i paraqet Kuvendit projektligjet me propozimet përkatëse, në përputhje me qëllimet dhe detyrat e tij, brenda datës 31.5.2002.

VI. Komisioni do të veprojë sipas procedurave të përcaktuara në nenet 52-68 të Rregullores për komisionet e përhershme.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Namik Dokle